



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA
Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opština Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



01 Nr. 3536
Rahovec, 25.11.2016

Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 2 dhe nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 569/1 i datës 16.12.2010, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 25.11.2016, merr këtë:

V E N D I M

Për aprovimin e Strategjisë Komunale për komunikim dhe Informim për periudhën 2017 - 2021


- I. Aprovohet Strategjia komunale për Komunikim dhe Informim për periudhën 2017 - 2021
- II. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset zyra e Kryetarit të Komunës.
- III. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Rahovec, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, nenit 8, të Rregullores së (QRK), Nr-01/2016, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

Me vendim të njoftohen:

1. Zyra e Kryetarit,
2. Shërbimi i Kuvendit dhe
3. Arkivi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odseljenje za Opštu Upravu



Kryesuesi i Kuvendit

Nahit Elshani

-III- Nr. i prot. 3536 Më 25.11.2016
Br. prot. Dt. 2016
RAHOVEC - ORAHOVAC



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipal Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E ORAHOVACIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtori i Administratës të përgjithshme
Ceshtje të Opštine Upravu



-III- Nr. i prot. 3536 Më 25. 11. 2016
Br. pikt. Dt. 25. 11. 2016
RAHOVEC - ORAHOVAC

Strategjia për Komunikim dhe Informim 2017-2021

Financuar nga Komuna e Rahovecit

Rahovec
2016

1. Përmbajtja
2. Fjala e kryetari të Komunës
3. Hyrja
4. Korniza ligjore për hartimin Strategjisë
5. Shkurtesat
6. Anëtarët e grupit punues
7. Analiza e gjendjes
8. Metodologjia
9. Qëllimet i strategjisë
10. Sfidat e Strategjisë
11. Mbledhja e stafit
12. Telefoni
13. Komunikimi i brendshëm elektronik
14. Tabelat e shpalljeve
15. Komunikimi i brendshëm me shkrim
16. Konferencat për shtyp
17. Komunikata për shtyp
18. Intervista
19. Ueb faqja
20. Buletini mujor elektronik-informativ
21. Debatet me publike dhe takimet me qytetarë
22. Këshillat e fshatrave, lagjeve dhe vendbanimeve
23. Marrëdhëniet me shfrytëzues të shërbimeve
24. Afaristët, investitorët dhe donatorët
25. Bashkëpunimi me organet shtetërorë
26. Përfaqësitë diplomatik dhe organizatat ndërkombëtare
27. Diaspora
28. Qytetet dhe Komunat partnere
29. Promovimi i Komunës së Rahovecit
30. Qasja në dokumente publike
31. Komunikimi i brendshëm
32. Zbatimi i strategjisë për komunikim dhe informim
33. Plani i Veprimit
34. Evaluimi

2.Fjala e Kryetarit

Të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit,

Përgatitja e Strategjisë për Komunikim dhe Informim të Komunës së Rahovecit, ka për synim t'i ofrojë publikut qasje në monitorimin dhe zbatimin e publikimit të akteve të Komunës dhe aktiviteteve të tjera, duke përfshirë edhe menaxhimin e financave dhe prokurimin publik, si dhe përgjegjësi të tjera që ndërlidhen me interesin e publikut.

Qëllimi i përgatitjes së Strategjisë për Komunikim dhe Informim të Komunës së Rahovecit është promovimi dhe avancimi i transparencës së organeve të Komunës së Rahovecit dhe administratës komunale në informimin efektiv të qytetarëve dhe grupeve të tjera të interesit, që kanë të bëjnë me aktivitetet e ndërmarra për ushtrimin e kompetencave.

Strategjia për Komunikim dhe Informim e Komunës së Rahovecit, ka për qëllim plotësimin edhe të Rregullores për Transparencë dhe Planit të Veprimit për transparencë në Komunë.

Hartimi dhe zbatimi i Strategjisë për Komunikim dhe Informim të Komunës së Rahovecit është një hap tjetër në punën dhe përkushtimin tonë me synim, sigurimin e konsolidimit të një shoqërie me vlera të përparuara demokratike, që kujdeset për të gjithë qytetarët e saj, pa dallim përkatësie etnike, fetare dhe politike.

Ky dokument do të jetë një ndihmesë e madhe për gjitha drejtoritë komunale, zyrën për Komunikim dhe Informim me Publikun, që do të kujdeset për ngritjen e komunikimit, bashkëpunimit në mes të qytetarëve Kryetarit dhe ekzekutivit të Komunës, administratën, komitetet, komisionet dhe këshillat komunale, të cilët veprojnë në kuadër të Komunës së Rahovecit.

Kryetari
Prof. Dr. Idriz Vehapi

3.Hyrja

Territori i Komunës së Rahovecit ka një sipërfaqe prej 276,078983 km² dhe ka 56.208 banorë. 55.166 janë Shqiptar, 787 RAE, 134 Serb dhe 38 të tjerë dhe shtrihet në rajonin e Prizrenit. Ka pozitë të favorshme gjeografike dhe kufizohet me Komunat si Gjakova, Prireni , Malisheva, Mamushën dhe Suhareka.

Territori i Komunës shtrihet në gjerësi prej 420 30' deri 420 50' dhe në gjatësi nga 20021' deri më 20055'. Në komunën e Rahovecit, vendbanimet shtrihen nga 300 m. (Krushë e Madhe) deri në 920 m (Zatriqi) mbi nivel të detit.

Komuna e Rahovecit ka 1 qendër urbane, 33 fshatra dhe 3 vendbanime me , ka 3 shkolla të mesme të larta, 1 shkollë profesionale, 24 shkolla fillore të mesme të ulëta, 9 paralele të ndara fizike, 1 çerdhe të fëmijëve ,1 shkollë të ulët të muzikës, 1 shkollë të mesme serbe dhe 2 shkolla fillore serbe.

Në komunën e Rahovecit ushtrojnë aktivitete shumë organizata të shoqërisë civile me profile të ndryshme sociale, rinore, sportive, kulturore, ekonomike e bujqësore.

4.Korniza ligjore për hartimin Strategjisë

Ky dokument është hartuar në përputhshmëri me kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me strukturën institucionale ligjore, Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit mbi Qasjen në Dokumentet Publike, Statutit të Komunës, si dhe akteve të tjera normative lokale.

Strategjia përbën kornizën e përbashkët për të gjitha arteriet ndërmjet Komunës me qytetarin, shoqërinë civile, mjetet e informimit, më synim që të arrihen mënyra të shumta të komunikimit.

Komuna e Rahovecit e ka të miratuar Rregulloren për Transparencë, që qartëson detyrat dhe përgjegjësitë e organeve komunale ndaj qytetarëve. Komuna, po ashtu e ka të miratuar edhe Planin vjetor të veprimit për transparencë. Për hartimin e draftit të parë të kësaj Strategjie për Komunikim dhe Informim, është formuar grupi punues i përbërë nga zyrtarë komunal, shoqëria civile dhe përfaqësues të tjerë.

Strategjia do të shqyrtohet në Kuvendin e Komunës dhe do të vihet në diskutim publik me qytetarët. E njëjta do të publikohet edhe në ueb faqe të Komunës, ku mund të bëhen sugjerime, vërejtje dhe plotësime, e më pas të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Komunës.

5.Shkurtesat:

OJQ- Organizatat joqeveritare

OSBE-Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

SKI-Strategjia për Komunikim dhe Informim

ZK-Zyra e Kryetarit

RAE- Rom, Ashkali dhe Egjiptian

KKSB-Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
KPF-Komiteti për Politik dhe Financa
ZIMP-Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

6. Anëtarët e grupit punues:

Nahit Elshani-Kryesesi i Kuvendit Komunal
 Sali Sallteku-Drejtori i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme
 Shkumbin Arifi-Qendra Rinore në Rahovec
 Betim Behluli- Zyra Ligjore
 Haziz Krasniqi-Kabineti i Kryetarit të Komunës

7. Analiza e gjendjes

PËRPARËSITË	DOBËSITË
-Stafi i kualifikuar i Komunës së Rahovecit për fushën e komunikimit. -Funksionimi i disa medieve lokale (Dy portale). -Interesimi i Komunës për të informuar me kohë opinionin dhe për të plasuar në afatin ligjor dokumentet , vendimet dhe materialet relevante në ueb faqen zyrtare -Marrëdhënie korrekte me mediet dhe gazetarët.	-Mungesa e besimit të qytetarëve për komunikim me institucionet, si pasojë e mosbesimit nga koha e shkuar, kur pushteti konsiderohej i huaj. -Interesimi i dobët i qytetarëve për të diskutuar apo adresuar çështje me interes.
MUNDËSITË	RREZIQET
-Përdorimi i ueb faqes së Komunës edhe për plasimin e informatave tjera, jo vetëm aktivitetet e Komunës dhe të Kryetarit. -Postimi i lajmeve edhe pas orarit të punës, apo direkt nga terreni. -Përdorimi i operatorëve mobilë për të plasuar njoftime info të shkurtëra përmes SMS-ve tek qytetarët, institucionet apo personalitetet me rëndësi dhe ndikim.	-Komuna mund të humb besim në rast të komunikimit të një anshëm apo njëdrejtimësh, duke mos dëgjuar apo marrë në konsideratë çfarë thonë të tjerët. -Komuna mund të humbasë besimin nëse bën komunikim joadekuat, në rastet kur përballet me kritika, pyetje jo të përshtashme apo interesim më të thellë të medieve apo qytetarëve për çështje të caktuara.

8. Metodologjia

Strategjia është e strukturuar në mënyrë që rezultatet të arrijnë te secili qytetar dhe secili institucion. Kërkon respektimin e parimeve dhe politikave që bazohen në vlerat demokratike, udhëzon për përdorimin e metodave dhe veglave efektive, si dhe obligon të gjitha palët që të kontrollojnë dhe të masin cilësinë dhe performancën gjatë zbatimit të saj. Qeverisja lokale është e përkushtuar të integrojë sa më shumë dhe sa më mirë të gjitha institucionet publike dhe private, duke u bazuar në mundësitë ligjore, të përmirësojë mënyrën e komunikimit dhe të mbështesë të gjitha palët që jetojnë në komunën e Rahovecit. Kjo do të arrihet duke u përmirësuar dhe duke i zhvilluar më shumë marrëdhëniet midis Komunës dhe qytetarëve - Komunës dhe institucioneve private-Komunës dhe organizatave të ndryshme joqeveritare- Komunës dhe institucioneve publike. Në mënyrë të mbledhjes së informacioneve të nevojshme, para hartimit të këtij dokumenti, të një rëndësie të madhe për transparencë dhe llogaridhënie, Komuna e Rahovecit ka formuar grupin e përbashkët të përbërë nga zyrtarë Komunalë, shoqëria civile dhe përfaqësues të OSBE-së.

Deri te ky dokument ka arritur pas mbajtës së disa punëtorive të organizuara nga OSBE dhe mbajtjes së tri debateve, siç janë debati i mbajtur në Qendrën Rinore në Rahovec, në lagjen e epërme, e banuar me shumicë nga komunitet RAE dhe debati në fshatin Hoçë e Madhe, i banuar nga komuniteti serb.

Si rezultat i një analize të tillë sistematike, janë definuar qëllimet specifike, të rëndësishme dhe të realizueshme që synohen të arrihen, si dhe aktivitetet që do të ndërmerren për të arritur ato.

9. Qëllimet i strategjisë

Realizimi i SKI-së në baza afatgjata, ka për qëllim vendosjen e një sistemi të thjeshtë, unik, funksional dhe të zbatueshëm të komunikimit, i cili do të mundësojë realizimin e qëllimeve të vëna si:

Transparenca dhe përgjegjësia publike e Komunës, përmes komunikimit efikas me palët/qytetarët dhe përmes informimit mbi procedurat dhe të drejtat e tyre për qasje në dokumente publike;

Nxitjen e qytetarëve për pjesëmarrje aktive në vendimmarrje dhe në aktivitetet komunale, me qëllim të rritjes dhe bashkëpunimit dhe besimit të ndërsjellë;

Ngritjen e cilësisë së kapaciteteve të komunikimit me grupe të interesit e sidomos me qytetarët, afaristët, investitorët dhe nivelet e larta të shtetit;

Ngritjen e cilësisë së komunikimit me mediet;

Transparencën financiare dhe racionalizimin e komunikimit brenda dhe jashtë Komunës;

Vendosjen e një sistemi efikas të komunikimit të brendshëm;

Përmirësimin e imazhit të përgjithshëm të Komunës së Rahovecit.

10.Sfidat e Strategjisë

Qeverisja lokale të formojë një zyrë për koordinimin e këshillave të fshatrave në mënyrë që t'i bashkërendojë punët dhe të rrisë bashkëpunimin me kryetarët e lagjeve dhe fshatrave të komunës së Rahovecit,

Të formohet zyra pritëse që do t'ju mundësojë qytetarëve marrjen më të shpejtë dhe me efikase të shërbimeve,

Të formohet baza e shënimeve pasi që deri me tani nuk ekziston një bazë e përgjithshme e shënimeve dhe e të dhënave për Komunën e Rahovecit.

Komuna e Rahovecit deri tani ka arritur binjakëzim apo partneritet me disa qytete nga rajoni dhe bota. Kjo praktikë edhe i ka sjellë Komunës përfitime, duke këmbyer përvoja të mira dhe duke përfutur edhe donacione konkrete.

Komuna ka mungesë përvoja në këtë drejtim, prandaj kërkohet pjesëmarrja e vazhdueshme në panairë të ndryshme me qëllim të përfitimit dhe shkëmbimit të përvojave të ndryshme.

Tabelat e shpalljeve, si mjet komunikimi, nuk shfrytëzohen në masë të kënaqshme, qoftë nga zyrtarët komunal, shoqëria civile apo qytetarët në përgjithësi.

Nuk ka rregullore, as ndonjë protokoll unik, por ekziston evidenca e komunikatave të publikuara dhe reagimeve.

11.Mbledhja e stafit

Në nivel të qeverisjes komunale janë paraparë mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve, që mbahen çdo të hënë, me fillim në ora 09:30. ZIMP publikon të dhëna të përmbledhura nga mbledhjet e Këshillit.

Mbledhjet e KPF-së, Kuvendit Komunal dhe të komiteteve të tjera të Kuvendit, mbahen një herë në muaj, sipas ligjeve në fuqi.

Mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve janë me karakter raportues, informues dhe planifikues. Kryetari i Komunës, sipas nevojës, mban mbledhje dhe takime ditore me organet përkatëse.

Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit Komunal, vendosin për caktimin e rendit të ditës të seancave të Kuvendit Komunal.

12.Telefoni

Rrjeti i telefonisë fikse funksionon rregullisht. Po ashtu edhe rrjeti i telefonisë mobile, pa pagesë, funksionon mirë, pasi të gjithë punonjësit e Komunës janë në grup të mbyllur dhe komunikimin në mes vete e kanë pa pagesë.

13. Komunikimi i brendshëm elektronik

Komunikimi i brendshëm në Komunën e Rahovecit funksionon në nivelin e dëshirueshëm, sepse për këtë janë krijuar parakushte teknike. Të punësuarit në Komunë kanë program të instaluar elektronik për komunikim të shpejtë apo out-look dhe intranet.

14. Tabelat e shpalljeve

Në ndërtesën e Komunës së Rahovecit janë të vendosura disa tabela të shpalljeve në vende të dukshme, ku vendosen shpalljet, publikimet, vendimet. Tabela nuk ka në pjesën më të madhe të drejtorive komunale, por shpalljet vendosen në dyer të hyrjes apo afër tyre. Kurse drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport është vendosur në Shtëpinë e Kulturës “Mensur Zyberaj” në qytetin e Rahovecit.

15. Komunikimi i brendshëm me shkrim

Rritja e komunikimit të brendshëm me shkrim, të gjitha dokumentet e shkruara pa gabime drejtshkrimore dhe stilistike

16. Konferencat për shtyp

Të vazhdohet praktika e dhënies së intervistave, të rregullohet mënyra e organizimit të konferencave të shtypit, të krijohen hapësira dhe kushte teknike për mbajtjen e konferencave të shtypit në objektin e Komunës.

17. Komunikatat për shtyp

Komunikatat për shtyp janë mënyra më e shpeshtë e plasimit të informacioneve tek opinioni përmes medieve. Komuna e Rahovecit sipas nevojës dhe me kërkesë të kryetarit, nënkryetarit, apo zyrtarëve tjerë përpilon komunikata të ndryshme. Komunikatat përgatitën nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun (ZIMP) dhe njofton mediet.

18. Intervistat

Intervistat kryesisht jepen nga kryetari i Komunës, Nënkyetari, drejtorët e drejtorive, apo zyrtarë tjerë të autorizuar. Kryetari i Komunës iu drejtohet qytetarëve për çdo fundvit dhe në raste të festave kombëtare, shtetërore, komunale apo fetare.

19. Ueb faqja e Komunës

Ueb faqja e parë zyrtare e Komunës së Rahovecit daton nga **15.08.2003** ndërkaq me standardizimin e ueb faqeve zyrtare për të gjitha komunat nga viti **2010** është funksionale kjo: <http://kk.rks-gov.net/rahovec/Lajmet.aspx> .

Në ueb faqen e komunës mund të gjeni informata të shumta mbi Komunën, udhëheqjen lokale, Kuvendin, projektet, dokumentet dhe përditësohet për çdo ditë me të dhëna dhe informacione të reja.

20. Buletini mujor elektronik-informativ

Në buletinin Informativ qytetarët e komunës së Rahovecit do të informohen me aktivitetet komunale përfshirë punën e qeverisë komunale, zyrtarëve komunal, Kuvendit. Gjithashtu në këtë buletin do të pasqyrohen projektet e realizuar për një periudhë të caktuar. Informacionet do të paraqiten në mënyrë neutrale dhe pa komente; Buletini Informativ elektronik nuk mund të përdoret për qëllime politike, fetare, ideologjike, partiake apo komerciale.

21. Debatet publike dhe takimet me qytetar

Statuti i Komunës së Rahovecit dhe Rregullorja për transparencë nr 01/2016, përcaktojnë mënyrat dhe procedurat e pjesëmarrjes së qytetarëve në çështjet publike. Takimet apo debatet publike që i organizojnë organet komunale, mbahen rregullisht apo sipas nevojës. Kryetari i Komunës mban dyert të hapura një herë në javë për takime me qytetarë lidhur me kërkesat dhe problemet e tyre.

22. Këshillat e fshatrave, lagjeve dhe vendbanimeve

Komuna e Rahovecit përbëhet prej 1 qendre urbane 33 fshatra dhe 3 vendbanime, në të gjitha fshatrat dhe lagjet, janë të formuara dhe janë funksionale Këshillat lokale, përmes të cilave realizohen aktivitetet për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarje për çështjet në interes publik për banorët lokal dhe për zgjidhjen e problemeve të tyre.

Komunikimi me këshillat e fshatrave dhe lagjeve të qytetit të Rahovecit, bëhet përmes kontakteve të drejtpërdrejta, apo përmes shkresave dhe telefonit. Kryetarët e fshatrave dhe lagjeve të qytetit të Rahovecit, ftohen në të gjitha aktivitetet dhe ngjarjet me rëndësi që i organizon komuna. Po ashtu, Komuna ua mbulon shpenzimet e telefonit kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve, duke i futur në grup ashtu siç janë edhe zyrtarët e tjerë të Komunës së Rahovecit dhe komunikimi me ta është pa pagesë. Kryetarët e këshillave të fshatrave informojnë me shkrim zyrtarin për bashkëpunim dhe bashkërendim për problemet që në vendbanimet e tyre.

23.Marrëdhëniet me shfrytëzues të shërbimeve

Banorët e komunës së Rahovecit janë grup kryesor i interesit të cilit i sigurohet informim i shpejtë dhe i saktë për realizimin e të drejtave të tyre. Banorët e komunës së Rahovecit kanë qasje të drejtpërdrejt në organet komunale përmes telefonit apo internetit. Përgjigjet në kërkesat e tyre bëhen sipas procedurave të parapara me ligj. Me qëllim të informimit dhe njohjes me organet komunale dhe të drejtat e qytetarëve, komuna ka vendosur organogramet në vende të dukshme brenda objektit të Komunës.

24.Afaristët, investitorët dhe donatorët

Afaristët, investitorët dhe donatorët marrin informata përmes kontakteve me drejtorët relevant ose përmes takimeve të zyrtarëve komunal me këto subjekte. Në Komunën e Rahovecit funksionojnë shoqatat e ndryshme të afaristëve, bujqve dhe grupe të ndryshme të interesit shoqëror.

Komuna e Rahovecit do të përgatisë broshura të ndryshme informuese për subjektet e interesuara afariste. Komuna e Rahovecit ka organizuar konferencë për prezantimin e resurseve për turizmin në territorin e komunës. Komuna do të shqyrtojë mundësitë për organizimin e konferencave për donatorë apo ngjarje të ngjashme lidhur me zhvillimin ekonomik dhe turizmin.

25.Bashkëpunimi me organet qendrore shtetërore

Komunikimi me organet e nivelit qendror bëhet në përputhje me ligjet në fuqi. Përpos kësaj, komunikimi bëhet përmes vizitave, kontakteve të drejtpërdrejta, telefonit, e-malit, dokumenteve të shkruara e të ngjashme. Marrëdhëniet me institucionet e ndryshme, siç janë ambasadat dhe zyrat përkatëse, mbahen përmes kryetarit të Komunës dhe zyrtarëve të tjerë të autorizuar. Korrespondenca me institucionet e tjera të qeverisë qendrore apo lokale realizohet nga kryetari, dhe nga persona të tjerë të autorizuar.

26.Përfaqësimi diplomatik dhe organizatat ndërkombëtare

Komuna e Rahovecit mban komunikim të rregullt me përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare në Kosovë. Komuna posedon listën kontaktuese e cila përditësohet rregullisht. Komuna e Rahovecit fton rregullisht përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare dhe ambasadave apo përfaqësive diplomatike në aktivitetet e rëndësishme që organizohen në Komunë.

27.Diaspora

Komuna e Rahovecit deri tani ka bashkëpunuar me diasporën. Komuna për çdo vit në muajt korrik-gusht organizon manifestimin „Ditët e Diasporës“, ku përfshihen takime me mërgimtarë,

koncerte, turne sportive, ekspozita etj. Po ashtu, kryetari realizon vizita të kohëpaskohshme në diasporë, ku takohet me bashkëvendas nga Rahoveci.

28. Qytete dhe Komunitat Partnere

Thellimi i marrëdhënieve me qytetet partnere, binjakëzimit me komunitat e reja dhe rritja e bashkëpunimit ndërkomunal dhe rajonal, vazhdimi me praktikën e komunikimit të mirë me qytetet potenciale partnere në kuadër të projekteve dhe programeve ndërkombëtare

29. Promovimi i Komunitetit të Rahovecit

Përveç njoftimeve të rregullta në ueb faqen zyrtare, Komunitati e Rahovecit do të shqyrtojë mundësinë e fillimit të botimit të materialeve promovuese, respektivisht botimin e buletinit mujor. Komunitati shpërndan materiale promovuese si; lapsa, notesa dhe kalendarë.

Komunitati organizon manifestime kombëtare e ndërkombëtare nga fusha e kulturës, sportit, bujqësisë etj.

Nga këto aktivitete Komunitati e Rahovecit ruan arkivin e fotografive, dokumenteve, investimeve, manifestimeve të ndryshme, promovimeve dhe ngjarjeve të rëndësishme komunale.

30. Qasja në dokumente publike

Ligji për Qasje në dokumente Publike respektohet në përpikëri. E drejta e parashtrimit të kërkesave për qasje në dokumentet publike, kryesisht shfrytëzohet nga organizatat jo qeveritare edhe pse me ligj të drejtën për të parashtruar kërkesa të tilla kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Me qëllim që parashtruesit e kërkesave të njihen mbi të drejtat e qasjes në dokumentet publike ZIMP ka vendosur një rubrikë të veçantë në ueb faqen zyrtare, ku janë të sistemuara informatat bazike mbi këtë të drejtë; ligji përkatës, si dhe dokumentet që janë në interes të qytetarëve. Më shumë informata mund të gjeni këtu: <http://kk.rks-gov.net/rahovec/Municipality/Qasja-ne-Dokumentet-zyrtare.aspxlinku>

31. Komunikimi i brendshëm

Për momentin, komunikimi i brendshëm në Komunitetin e Rahovecit funksionon përmes takimit të Kryetarit me Këshillin e Drejtorëve, përmes intranetit dhe shkresave zyrtare.

Me qëllim të komunikimit më efektiv të brendshëm, ndërmjet nëpunësve civil, po ashtu edhe ata politik, shihet e nevojshme komunikimi me Zyrën për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, me qëllim të publikimit të informatave që janë të nevojshme për t'u publikuar.

Përdorimi i telefonave, internetit, e-meilave zyrtar, tabelat e shpalljeve është më efektiv edhe mënyra e komunikimit dhe lehtësimi i punës së zyrtarit të ZIMP.

32.Zbatimi i Strategjisë

Zbatimi i Strategjisë do të bëhet nga të gjithë drejtorët dhe zyrat që në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës:

1. Zyra për Komunitete;
2. Zyra për Komunikim dhe Informim;
3. Zyra e Personelit;
4. Zyra Ligjore;
5. Zyra për përfaqësim ligjor;
6. Njësia e Auditorit të Brendshëm;
7. Zyrtari për Integritet Evropian;
8. Zyrtari për Çështje Gjimore;
9. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme;
10. Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Zurizëm ;
11. Drejtoria për Shërbime Publike;
12. Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit;
13. Drejtoria e Inspeksionit;
14. Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër;
15. Drejtoria për Arsim;
16. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
17. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim;
18. Drejtoria për Bujqësi, Pylltaridhe Zhvillim Rural;
19. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport;
20. Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Vërejtje: Zyra për Informim dhe Drejtoria e Administratës së Përgjithshme do të jenë organe përgjegjëse për monitorimin, kontrollimin, vlerësimin e ecurive të zbatimit të kësaj strategjie. Në rast të ngecjes në zbatimin e kësaj strategjie, Zyra për informim do të kërkojë nga Zyra e Kryetarit iniciimin e masave gjegjëse për zbatimin e Strategjisë.

Vërejtje: Më poshtë keni planin e veprimit të Strategjisë për Komunikim dhe Informim të Komunës së Rahovecit dhe në këtë plan mund të gjeni: Qëllimin, aktivitetet, afatet realizimit, bartësit e përgjegjësive dhe koston e zbatimit të kësaj strategjie.

33. PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË PËR KOMUNIKIM DHE INFORMIM NË KOMUNËN E RAHOVECIT 2016-2021

Mbledhja e stafit:				
Qëllimi	Aktivitetet	Afati i realizimit	Bartësi i përgjegjës	Kosto
Rritja e informimit të të punësuarve përmes mbledhjeve të brendshme. Përparimi dhe sistematizimi i komunikimit përmes mbledhjeve të të gjitha niveleve. Zbatimi konsistent i obligimeve që dalin nga mbledhja.	Mbledhjet e rregullta javore të udhëheqësve të organeve me të punësuarit.	Në vazhdimësi	Udhëheqësi i shërbimit	00
		Në vazhdimësi	Administratori kryesor dhe udhëheqësit	00
	Sipas nevojës organizimi i mbledhjeve të kryetarit me udhëheqësit e organeve të administratës me qëllim të njohjes me kohë me ligjet dhe aktet e reja të nevojshme për punën e tyre.	Sipas nevojës	Kryetari i Komunës dhe kryesuesi i Kuvendit	00
	Përvec takimit të kryetarit të Komunës me kryesuesin e Kuvendit Komunal, është i nevojshëm edhe			

	një takim ku do të shqyrtohet realizimi i akteve të miratuara në Kuvend			
Telefoni:				
Qëllimi	Aktivitetet	Afati i realizimit	Bartësi i përgjegjës	Kosto
Të ketë qasje të përhershme, Të shkurtrohet koha e komunikimit	Komuna e Rahovecit ka përpiluar listën e brendshme me numra të telefonit. Të krijohet një numër pa pagesë (0800) që do të jetë në shërbim të qytetarëve.	2016 2016	Zyra e kryetarit	00
Komunikimi i brendshëm elektronik				
Qëllimi	Aktivitetet	Afati i realizimit	Bartësi i përgjegjës	Kosto
Të vendoset komunikimi i brendshëm elektronik me të cilën mundësohet punë më cilësore.	Komuna e Rahovecit u ka siguruar të gjithë punëtorëve komunale numra të telefonit dhe kompjuter të mjaftueshëm. Të gjitha organeve komunale t'i sigurohet qasje në internet dhe të krijohen adresa	Në vazhdimësi Në vazhdimësi Në vazhdimësi	Drejtoria përkatëse Personi përgjegjës për teknologji informative Njësia e personelit, në bashkëpunim me mekanizmat e tjerë	00 00 00

	elektronike (e-mail) zyrtare. Trajnimi i zyrtarëve komunale për përdorimin e kompjuterëve dhe interneti në komunikim të ditor. Rrjetëzimi i të gjithë kompjuterëve në një sistem me qëllim të përcjelljes elektronike të rrjedhës së lëndëve	2016	Përsioni përgjegjës për teknologji informative zbatimi i programeve të E-Qeverisjes	
--	--	------	---	--

Tabela e shpalljeve

Qëllimi	Aktivitetet	Afati realizimit	Bartësi i përgjegjësisë	Kosto
Përparimi i komunikimit të jashtëm përmes tabelave të shpalljeve.	Vendosja e tabelave në mënyrë estetike dhe teknike në të gjitha objektet ku janë të vendosura organet lokale.	2016-2017 2016	Drejtoria e Administratës Të gjitha drejtoritë	30 euro copa, për 12 drejtori totali 360 euro. 00
	Caktimi nga drejtori i drejtorisë i një personi i cili do të ngarkohet me vendosjen e shpalljeve dhe mirëmbajtjen e tabelave			

Komunikimi i brendshëm me shkrim				
Qëllimi	Aktivitetet	Afati i realizimit	Bartësi i përgjegjës	Kosto
Arritja e komunikimit të brendshëm funksional me shkrim. Të gjitha dokumentet e shkruara pa gabime drejtshkrimore dhe stilistike	Në komunikimin e brendshëm më shumë shfrytëzohen përparësitë e komunikimit përmes e-mailit. Në nivel të organeve lokale të rregullohen në aspektin teknik dhe estetik pamja e dokumenteve. Doemos të lekturohen tekstet	Në vazhdimësi Lektori	Të gjithë zyrtarët	00 00
Konferenca për shtyp				
Qëllimi	Aktivitetet	Afati i realizimit	Bartësi i përgjegjës	Kosto
Të vazhdohet praktika e dhënies së intervistave. Të rregullohet mënyra e organizimit të konferencave të shtypit. Të krijohen hapësira dhe kushte teknike	Organizimi i intervistave si për kryetarin po ashtu edhe për drejtorët. Rregullimi i një zyre për mbajtjen e konferencave për shtyp	2016-2021 2016	Kabineti i Kryetarit dhe ZIMP Zyra e kryetarit	00 800 euro

për mbajtjen e konferencave të shtypit në objektin e Komunës				
Komunikata për shtyp				
Qëllimi	Aktivitetet	Afati i realizimit	Bartësi i përgjegjës	Kosto
Rregullimi i mënyrës së dërgimit të komunikatave	Të arkivohen rregullisht tekstet e botuara në mediet e shkruara apo elektronike, si dhe në radio e TV, që kanë të bëjnë me aktivitetet e Komunës së Rahovecit, apo që ndërlidhen me punën e saj. Të bëhet protokolli për shkrimin dhe plasimin e komunikatave për shtyp.	Në vazhdimësi prej vitit 2016 2016	Zyra e kryetarit Zyra e kryetarit	00 00
Intervistat				
Qëllimi	Aktivitetet	Afati i realizimit	Bartësi i përgjegjës	Kosto
Rregullimi i dhënies së intervistave Rritja e numrit të emetimeve komerciale në mediat lokale	Transmetimi i seancave të Kuvendit Komunal	Në vazhdimësi	Zyra e kuvendit	00

Ueb faqja e Komunës				
Qëllimi	Aktivitetet	Afati i realizimit	Bartësi i përgjegjës	Kosto
Rritja e numrit të vizitave	Promovimi i faqes së internetit me qëllim rritjen e interaktivitetit të shfrytëzuesve.	Në vazhdimësi	ZIMP	00
Të qenit gjithmonë aktual	Analizimi i vërejtjeve apo sugjerimeve të dërguara nga qytetarët.	Në vazhdimësi	Udhëheqësit e organeve lokale ZIMP	00
	Përditësimi i ueb faqes	Në vazhdimësi		00
Buletini mujor elektronik-informativ				
Qëllimi	Aktivitetet	Afati i realizimit	Bartësi i përgjegjës	Kosto
Informimi i qytetarëve me aktivitetet e Komunës.	Mbledhja e shënimeve Krijimi dhe botimi i buletinit mujor elektronik	Në vazhdimësi	ZIMP ZIMP, zyra e kryetarit dhe donator të mundshëm	00
Debatet publike dhe takime me qytetar				
Qëllimi	Aktivitetet	Afati i realizimit	Bartësi i përgjegjës	Kosto
Rritja e pjesëmarrjes së	Promovimi i debateve publike		Organet e vetëqeverisjes lokale	

qytetarëve në takime dhe debate publike.	Informimi i qytetarëve me të drejtat e tyre. Përmbytjen dhe parimet e debateve publike	Në vazhdimësi	Spektori përkatës	00
Këshillat e fshatrave, lagjeve dhe vendbanimeve				
Qëllimi	Aktivitetet	Afati i realizimit	Bartësi i përgjegjësisë	Kosto
Vendosja e mekanizimit efikas të komunikimit përmes këshillave të fshatrave. Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në përgatitjen dhe marrjen e vendimeve. Mundësimi i informimit më të mirë dhe me kohë të banorëve nëpër fshatra.	Mundësimi i pjesëmarrjes së përfaqësuesve të fshatrave në procesin e marrjes së vendimeve të rëndësishme për lokalitetet e tyre. Aplikimi i praktikës që vendimet me interes për banorët lokalë të prezantohen në kuadër të këshillave të fshatrave. Vazhdimi i heqjes së shpenzimeve të telefonit për kryetarët e lagjeve dhe fshatrave	Në vazhdimësi	Organet e vetëqeverisjes lokale Zyra e Kuvendit Zyra e kuvendit dhe drejtoria për Buxhet dhe Financa	00
Marrëdhëniet me qytetarë shfrytëzues të shërbimeve				

Qëllimi	Aktivitetet	Afati i realizimit	Bartësi i përgjegjës	Kosto
Ofrimi më i shpejtë dhe më efikas i shërbimeve për qytetarët, Rritja e cilësisë të komunikimit me qytetarë, Rritja e nivelit të njohjes me aktivitetet e qeverisë lokale, Shkurtimi i kohës së pritjes për shërbime, Sistematizimi i komunikimit me anë të zyrave të pritjes /pranimi, Caktimi i një zyrtari për pritjen së qytetarëve.	Vendosja e mbishkrimeve me emrat e zyrtarëve dhe shërbimeve në të gjitha zyrat. Krijimi i udhëzuesit të zyreve në vende të dukshme. Vendosja e kutive të ankesave dhe sugjerimeve të qytetarëve, afër tabelave të shpalljeve tek secila drejtori Njoftimi i zyrtarëve mbi rregullat e komunikimit zyrtar.	Në vazhdimësi 2016 Në vazhdimësi	Drejtorja e Administratës Drejtoria përkatëse Drejtorja e Administratës ZIMP dhe drejtoritë përkatëse	 00 15 euro/copa 00
Afaristët, investorët dhe donatorët				
Qëllimi	Aktivitetet	Afati i realizimit	Bartësi i përgjegjës	Kosto
Vazhdimi dhe rritja marrëdhënieve të partneritetit me sektorin e biznesit Rritja e nivelit të	Organizimi i takimeve të rregullta informative me Shoqatën e afaristëve të Rahovecit dhe	Njëherë në vit	Drejtorja e Ekonomisë, Zhvillimit dhe Turizëm	

njohjes me projektet pozitive dhe të suksesshme të Komunës	me ndërmarrës.	Çdo fillim vit		
Rritja e njohjes me mundësitë e përfitimeve dhe bashkëpunimi me Komunën	Shtypja e materialit promovues dedikuar subjekteve afariste dhe ndërmarrësve.	2016-2017	Kryetari i Komunës, DEZht dhe donatorët	00
Rritja e numrit të investitorëve potencialë të cilët konsiderojnë se Komuna paraqet hapësirë të mirë për investime.	Organizimi i konferencave të donatorëve në të cilat afaristët do të mbështetnin aktivitetet humanitare apo të tjera të cilat i organizon komuna e Rahovecit.			
Bashkëpunimi me organet shtetërore				
Qëllimi	Aktivitetet	Afati i realizimit	Bartësi i përgjegjësive	kosto
Vendosja e një sistemi më efikas të komunikimit me organet qendrore.	Organizimi më i shpeshtë i takimeve me përfaqësues të organeve të shtetit, në të cilat do të njiheshin drejtpërdrejt me problemet me të cilat ballafaqohet Komuna e Rahovecit.	Në vazhdimësi	Kryetari i komunës dhe kryesuesi i Kuvendit Komunal	00
	Informimi	Në vazhdimësi	Kryetari i Komunës	00

	intensiv i nivelit të lartë për planet dhe projektet e Komunës së Rahovecit.			
Përfaqësuesit diplomatik dhe organizatat ndërkombëtare				
Qëllimi	Aktivitetet	Afati i realizimit	Bartësi i përgjegjësive	Kosto
Vendosja e një bashkëpunimi cilësor Ngritja e nismave për realizimin e projekteve	Organizimi i takimeve të rregullta në të cilat bashkë me përfaqësuesit e korit diplomatik dhe organizatave ndërkombëtare të prezantohen mundësitë për investime në Komunën e Rahovecit.	Në vazhdimësi	Kryetari i Komunës dhe kryesuesi i Kuvendit Komunal	00
Diaspora				
Qëllimi	Aktivitetet	Afati i realizimit	Bartësi i përgjegjësive	Kosto
Vendosja e komunikimit me klubet dhe shoqatat e mërgimtarëve nga komuna e Rahovecit.	Përmes ueb faqes të ftohen mërgimtarët në bashkëpunim të përhershëm, kontakte dhe lobim aty ku punojnë e jetojnë për komunën e Rahovecit.	Në vazhdimësi	Zyra e kryetarit	Sipas nevojës
Qytetet dhe				

Komunat Partnere				
Qëllimi	Aktivitetet	Afati i realizimit	Bartësi i përgjegjësive	Kosto
Thellimi i marrëdhënieve me qytetet partnere	Ngritja e nismave për ruajtjen e partneritetit dhe krijimi i partneriteteve të tjera.	Në vazhdimësi	Kryetari, kryesuesi dhe drejtorët e drejtorive Komunale	00
Shtimi i binjakëzimit me komunat e reja dhe rritja e bashkëpunimit ndërkommunal dhe rajonal	Organizimi i kurseve të gjuhëve të huaja për zyrtarët komunalë të cilët marrin pjesë në realizimin e projekteve dhe programeve ndërkombëtare	Në vazhdimësi		
Vazhdimi me praktikën e komunikimit të mirë me qytetet potenciale partnere në kuadër të projekteve dhe programeve ndërkombëtare.				
Promovimi i Komunës së Rahovecit				
Qëllimi	Aktiviteti	Afati i realizimit	Bartësi i përgjegjësive	Kosto
Arritja e promovimit të komunës së Rahovecit në nivel shtetëror dhe ndërkombëtar.	Krijimi i suvenirëve.	2016-2021	Drejtoria e Administratës dhe DEZHT.	Sipas nevojës
	Vazhimi i organizimit të ngjarjeve për qëllime promovimi	Në vazhdimësi	Zyra e kryetarit	Sipas nevojës
Qasja në dokumente				

publike				
Qëllimi	Aktivitetet	Afati i realizimit	Bartësi i përgjegjës	Kosto
Vazhdimi i zbatimit të Ligjit për qasje në dokumente publike	Të rritet tirazhi i udhëzuesit për qytetarët për realizimn e së drejtës për informim.	Në vazhdimësi	Drejtoria Administratës së Përgjithshme	Sipas nevojës
Totali:			10 000 Euro	

34.Evalvimi

Evalumi i aktiviteteve të planifikuara nga Strategjia për Komunikim dhe Informim të Komunës së Rahovecit, do të bëhet me:

Përgatitja e buletinit mujor për aktivitetet e Kryetarit, Kuvendi i Komunës, Drejtoritë dhe aktivitetet tjera të cilat organizohen në Komunën e Rahovecit.